

STANDARDET E KOMUNITETIT TË INTERNETIT TË BLACKBERRY

BlackBerry ka si qëllim për komunitetet dhe shërbimet tona në internet, të tilla si BBM Channels, që të jenë vende argëtuese e të sigurta ku njerëzit të ndajnë ide dhe informacione me persona të tjerët të cilët kanë interesa të ngjashme. Për të siguruar mbajtjen e një mjedisi mikpritës për përdoruesit tanë, është e rëndësishme që bashkëveprimi i përdoruesve tanë të bëhet në një mënyrë të tillë e cila përputhet me standardet e mëposhtme:

1. **Ji i respektueshëm.** Mos përgojo, abuzo, ngacmo, ndiq, kërcëno, dëmto ose për ndryshe mos dhuno të drejtat ligjore (të tilla si e drejta e privatësisë e publicitetit, dhe të drejtat e pronësisë me kontratë dhe intelektuale) të të tjerëve;
2. **Ji i sjellshëm.** Mos publiko, posto, vër, shpërnda ose përhap ndonjë temë, emër, material ose informacion jo të përshtatshëm, përdhosës, cenues, të papërshtatshëm, të turpshëm ose të paligjshëm;
3. **Ji i ligjshëm.** Mos shkel ndonjë prej ligjeve dhe rregullave të zbatueshme, ose mos posto apo transmeto programe spinuese, dëmtuese, viruse ose çdo gjë tjetër që mund të ndërpresë shërbimin ose të dëmtojë të tjerët;
4. **Ji i singertë.** Mos pretendo të jesh ndonjë person ose entitet, apo në mënyrë të gabuar të thoni ose përndryshe të paraqisni në mënyrë të gabuar marrëdhëniet tuaja me një person ose entitet, apo të krijoni një identitet të rremë për të mashtruar të tjerët, ose i cili rezulton në një përvojë të papritur, mashtruese ose të padrejtë për të tjerët; dhe
5. **Ji i përshtatshëm.** Mos “spam” ose u bini më qafë të tjerëve pa pëlqimin e tyre, përfshirë postime të dyfishta ose postime të shumëfishta të ngjashme, apo postimi i përmbajtjes që nuk i përshtatet diskutimit.

Standardet tona janë ndërtuar në mënyrë që të na ndihmojnë për ta çuar më përpara qëllimin tonë të krijimit të një përvoje interesante, të vlefshme, krijuese dhe më e rëndësishmja, të kënaqshme për përdoruesit tanë.